FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.173 dhjetor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.489, datë 20.7.2011	Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me punonjës të Policisë së Shtetit, në misionin e forcave të ndihmës për sigurinë ndërkombëtare (ISAF), në Afganistan	9735
Vendim i KM nr.823, datë 23.11.2011	Për një shtesë në vendimin nr.510, datë 6.7.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit"	9737
Vendim i KM nr.836, datë 23.11.2011	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, për vitin shkollor 2011-2012	9738
Vendim i KM nr.837, datë 6.12.2011	Për lejimin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të kontratës së nënshkruar, për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si autoritet kontraktor	9739
Vendim i KM nr.838, datë 6.12.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 4 bashki dhe 10 komuna	9740
Vendim i KM nr.839, datë 6.12.2011	Për shtyrjen e afatit të shpalljes së botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, të kryera nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	9741
Vendim i KM nr.841, datë 6.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Sharrës, faza III, në Bashkinë e Tiranës	9741
Vendim i KM nr.844, datë 6.12.2011	Për akordim fondi financiar shtesë njësisë bashkiake nr.2, Tiranë, për dhënie ndihme financiare familjes së viktimave Genc Mehmet Spahiu, Florida Niko Spahiu dhe Jona Genc Spahiu, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore të viktimave	9743

Vendim i KM nr.846, datë 6.12.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vora By-Pass", Tiranë	9743
Vendim i KM nr.847, datë 6.12.2011	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit për objektet e investimit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve në fushën e shëndetësisë, për vitin 2011.....	9745
Vendim i KM nr.849, datë 14.12.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.160, datë 2.3.2011 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2011, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave	9747
Vendim i KM nr.851, datë 14.12.2011	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit "Siguria e digave"	9748
Vendim i KM nr.852, datë 14.12.2011	Për lejimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR), Tiranë, për përfundimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urgjencës së Tiranës"	9757
Vendim i KM nr.853, datë 14.12.2011	Për lejimin e botimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të drejtorive rajonale rrugore në qarqe si autoritete kontraktore	9757
Vendim i KM nr.855, datë 14.12.2011	Për lejimin e botimit, në Buletinin e Prokurimeve Publike, të njoftimit për lidhjen e kontratës ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe subjektit ekonomik fitues në tenderin e zhvilluar me objekt "Ndërtimi i sistemit të rrjetit IT të DPM-së"	9758
Vendim i KM nr.856, datë 14.12.2011	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurën e prokurimit, me objekt "Blerje aparati Echo-je portabël, për sobin dhe shërbimin parësor të ASHR-së", Tiranë	9759
Vendim i KM nr.857, datë 14.12.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Mustafa Pepa	9759
Vendim i KM nr.858, datë 14.12.2011	Për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit nga Ministria e Brendshme, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë për disa shërbime	9760
Vendim i KM nr.859, datë 16.12.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për rritjen e pagave të punonjësve dhe shpërblimin e punonjësve me rastin e festave të fundvitit	9761
Udhëzim i MBUMK dhe MF nr.4363, datë 15.9.2011	Për shpenzimet dhe koston ekonomike, për zbatimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondi kundërparti dhe non projekt Grand aidi, të ardhura nga grandet japoneze, për sektorin e bujqësisë e të ushqimit	9761

Urdhër i MASH nr.493, datë 6.10.2011	Për shpërndarjen e kuotave të pranimit për programet e studimit të ciklit dytë, "Master profesional", për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja në institucionet publike të arsimit të lartë, viti akademik 2011-2012	9764
Urdhër i MASH nr.498, datë 7.10.2011	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës	9768
Urdhër i MASH nr.499, datë 7.10.2011	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në Qendrën e Studimeve Albanologjike të Tiranës	9768
Urdhër i MASH nr.500, datë 7.10.2011	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit	9769
Urdhër i MASH nr.501, datë 7.10.2011	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës	9770
Urdhër i MASH nr.502, datë 7.10.2011	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" të Tiranës	9770
Urdhër i MASH nr.512, datë 14.10.2011	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës	9771
Urdhër i MASH nr.513, datë 14.10.2011	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës	9772
Urdhër i MASH nr.516, datë 17.10.2011	Për shpërndarjen e kuotave për transferime studimesh, si dhe kuotave për programe të dyta studimi, për ciklin e parë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, viti akademik 2011-2012.....	9772
Urdhër i MASH nr.565, datë 23.11.2011	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional", të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë	9777
Urdhër i MASH nr.566, datë 23.11.2011	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master profesional", të universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	9778
Urdhër i MASH nr.567, datë 23.11.2011	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës në "Shkenca politike", në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës	9778
Urdhër i MASH nr.568, datë 23.11.2011	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master i shkencave" të Universitetit të Tiranës	9779
Vendim i ERE nr.128, datë 2.12.2011	Mbi lidhjen e kontratës të negociuar nga shoqëria "CEZ shpërndarje" sh.a. për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për vitin 2012	9780
Vendim i ERE nr.129, datë 6.12.2011	Për caktimin e ekspertit që do të përfaqësojë ERE-n në panelin rishikues të kërkuar nga "CEZ shpërndarje" sh.a.....	9781
Vendim i ERE nr.130, datë 6.11.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Snow Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Koka 1"	9781

Vendim i ERE nr.131, datë 6.12.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "Snow Energy" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ……	9782
Vendim i ERE nr.132, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Ulëz Shkopet" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Ulëz dhe hec Shkopet……	9783
Vendim i ERE nr.133, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec-Ulëz Shkopet" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ……	9784
Vendim i ERE nr.134, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Lanabregas ……	9784
Vendim i ERE nr.135, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ……	9785
Vendim i ERE nr.136, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 ……	9786
Vendim i ERE nr.137, datë 6.12.2011	Për licencimin e shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ……	9787
Vendim i ERE nr.138, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë KESH sh.a. për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014…..	9788
Vendim i ERE nr.139, datë 7.12.2011	Për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 ……	9788
Vendim i KSHNJ nr.1, datë 25.6.2011	Për përparësitë në çështjet që ofrohet ndihma juridike për vitin 2011 dhe 2012……	9789
Vendim i KSHNJ nr.2, datë 25.6.2011	Për rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike ……	9790
Vendim i KSHNJ nr.3, datë 25.6.2011	Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten formularit tip të kërkesës ……	9794
Vendim i KSHNJ nr.4, datë 25.6.2011	Mbi përcaktimin e masës së shpërblimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore ……	9797
Vendim i KSHNJ nr.5, datë 25.6.2011	Për kriteret e vlerësimit, format dhe standardet e kontrollit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike ……	9802

VENDIM
Nr.489, datë 20.7.2011

PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PUNONJËS TË POLICISË SË SHTETIT, NË MISIONIN E FORCAVE TË NDIHMËS PËR SIGURINË NDËRKOMBËTARE (ISAF), NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 438, datë 28.6.2011 "Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit Shqiptar në misione policore paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit" dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një grupi ekspertësh nga Policia e Shtetit, në kuadër të kontributit të NATO-s, në Afganistan (ISAF), si pjesë përbërëse e misionit trajnues të NATO-s në Afganistan (NTN-A).

2. Grupi i ekspertëve të Policisë së Shtetit, që do të dërgohet në këtë mision, përbëhet nga 5 (pesë) punonjës policie.

3. Misioni dhe detyrat e punonjësve të Policisë së Shtetit është të trajnojnë dhe të këshillojnë punonjësit e Policisë Afgane në Komandën Rajonale Qendrore (RC-C), pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Policisë, Kabul-Afganistan, me qëllim zhvillimin e një force policore afgane më profesionale.

4. Transporti strategjik është përgjegjësi e palës shqiptare dhe amerikane, e cila rregullohet nga dokumenti "Udhëzimi për sigurimin e transportit dhe mbështetjes për forcat e Aleancës në Irak dhe Afganistan" (Guidance for Providing Lift and Sustain Support to Coalition and Friendly Foreign in Iraq and Afghanistan).

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 (tre) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të grupit të parë në Afganistan, me rotacion çdo 6 (gjashtë) muaj.

6. Ministria e Brendshme të përballojë, për pjesëmarrësit në këtë mision, shpenzimet për:

a) shpërblimin që do të marrin punonjësit e policisë për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) shërbimet telefonike postare;

ç) transportimin e punonjësit të policisë për në atdhe, në raste vdekjesh, sëmundjesh dhe thyerjesh disiplinore;

d) veprimtaritë social-kulturore dhe festat kombëtare;

dh) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e operacionit.

7. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me INSIG sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të punonjësve të policisë të Republikës së Shqipërisë që do të marrin pjesë në këtë mision, për shumën e përgjithshme të përfitimit nga sigurimi i jetës, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për çdo punonjës policie.

8. Efektet financiare, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen si më poshtë vijon:

- 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave;

- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Brendshme, programi "Policia e Shtetit".

Për vitet në vazhdim, efektet financiare të përballohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

000/leke

Llogaritja e shpenzimeve për personelin NTM-A Kabul

Nr	ZËRAT E SHPENZIMEVE	NTM-A KABUL			
		Numri i Forcave	Kosto për një p/policie në ditë në	Kosto për një p/policie për fazë	Kosto totale për gjithë kontigjent
1	2	3	4	5	6
I	**SHPENZIME PËRPARA MISIONIT**				
1	Trajnim Kombëtar Faza e I-re Përpara Dislokimit				**1,326**
a	Bazë materiale stërvitje	**16**	**1.73**	43	692
b	Kancelari	**16**	**0.4**	10	160
c	Karburant	**16**	**0.7**	18	70
d	Çertifikimi	**16**	**0.04**	1	16
e	Materiale shëndetësore (vaksina, barna,materiale mjekimi dhe pajisje)	**16**	1	24	388
2	Trajnim Nderkombetar, Faza e II-te Përpara Dislokimit (14 dite)				1,980
2.1	Shpenzimi udhëtimi	**14**	**56**	**56**	784
2.2	Ushqim, akomodim dhe shpenz.tjera	**10**	**4.9**	69	686
2.3	Shpenz.per personelin qe kont.trainimin	**4**	**9.1**	**127.4**	510
3	Rikonicion Afganistan per 7 dite	**3**			284
a	Shpenzime udhëtimi	**3**	**70**	70	210
b	Dieta	**3**	**4**	25	74
	SHUMA NË LEKË I				**3,589**
II	**SHPENZIME GJATË MISIONIT**	**5**			
1	**SHPENZIME PERSONELI**	5		**2,708**	**13,540**
1.1	Pagesa ditore/Niveli i parë i rrezikshmërisë	5	12	2,160	10,800
1.2	Siguracion jete	5	3.044	548	2,740
2	**SHPENZIME TË TJERA**	**5**		**1,719**	**10,477**
2.1	Ushqim	5	1.8	324	1,620
2.2	Ekologji (Pastrim, higjenë)	5	0.2	27	135
2.3	Akomodim	5	0.5	90	450
2.4	Trajtim mjekësor	5	0.04	7	36
2.5	Karburant	1 mjet	0.06	11	22
2.6	Ujë i pijshëm	5	1.4	252	1,260
2.7	Pagesë asistence (Përkthyes)	5	7.0	1,260	6,300
2.8	Shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e operacionit		3.6	655	655
2.9	Siguracion mjetesh + Riparim automjete			-	-
3	**SHPENZIME PËR MBIVENDOSJEN**				**195**
3.1	Ushqim	5	1.8	18	90
3.2	Ekologji (Pastrim, higjenë)	5	0.2	2	8
3.3	Akomodim	5	0.5	5	25
3.4	Trajtim mjekësor	5	0.04	0	2

3.6	Ujë i pijshëm	5	1.4	14	70
4	**MBËSHTETJA SHËNDETËSORE**			**1,250**	**1,250**
4.1	Transport individësh të shkëputur për në atdhe, për raste sëmundjesh apo thyerje disiplinore	1 person		1,250	1,250
4.2	Mbështetja Shëndetësore dhe Sig.Shëndetësor			-	-
5	**SHPENZIME NDËRLIDHJEJE**				1,330
5.1	Telefon celular	6	0.22	40	240
5.2	Telefon satelitor	1	5.56	1,000	1,000
5.3	Internet	5	0.10	18	90
6	**Shpenzime per mbarevajtjen e kryerjes se misionit**				**700**
	SHUMA NE LEKE II				**27,491**
III	**Shpenzime pas mbarimit të misionit**				
1	Rehabilitim pas misionit	5	2.5	37.5	187.5
	SHUMA(III)		**2.5**	**37.5**	**187.5**
	TOTALI I SHPENZIMEVE(I+II+II)				**31,268**

VENDIM
Nr.823, datë 23.11.2011

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.510, DATË 6.7.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PEQIN, TË QARKUT TË ELBASANIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi të bashkisë Peqin të qarkut të Elbasanit, listë e cila i bashkëlidhet vendimit nr.510, datë 6.7.2011 të Këshillit të Ministrave.

Lista shtesë me një fletë, e cila përfundon në numrin rendor 8 (tetë), i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Peqin e qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Peqin Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
345-352	Pyje dhe sipërfaqe me bimësi pyjore	Pronësi

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Prona të veçanta të tipit pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Bashkia Peqin

Nr.	Nr. pron. sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike	Emërtesa e ngastrës Vendndodhja sipas emërtesës popullore	Nr. i ngast.	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	345	Zalli Shkumbin	Zalli Rrumbullake	12a	Pyje	1.6	Mbrojtës	MMPAU	DSHP	
2	346	“	Zalli Rrumbullake	12b_1	Sip. b. pyj.	9.9	-	“	“	
3	347	“	Zalli Rrumbullake	12c_1	Pyje	4.5	Mbrojtës	MMPAU	DSHP	
4	348	“	Zalli Rrumbullake	12d	Pyje	1.2	Mbrojtës			
5	349	“	Zalli Bardhas	13a_1	Pyje	5.3	Mbrojtës	MMPAU	DSHP	
6	350	“	Zalli Bardhas	13b	Sip. b. pyj.	1.0	-	MMPAU	DSHP	
7	351	“	Zalli Bardhas	13c	Pyje	1.36	Mbrojtës	MMPAU	DSHP	
8	352	“	Zalli Bardhas	13d_1	Sip. b. pyj.	15.41	-	MMPAU	DSHP	

VENDIM
Nr.836, datë 23.11.2011

PËR DHËNIEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2011-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit, nga të cilat 25 (njëzet e pesë) bursa studimi për nxënësit e viteve përgatitore dhe 59 (pesëdhjetë e nëntë) bursa studimi për nxënësit e viteve të para deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2011-2012.

2. Vlera e bursës të jetë 680 (gjashtëqind e tetëdhjetë) euro për nxënës, në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e bursës do të paguhet, për çdo nxënës, në lekë.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i "Fondacionit Shkollor Austriak", në mbështetje të kritereve ekonomike dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i "Fondacionit Shkollor Austriak", pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, e kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.837, datë 6.12.2011

PËR LEJIMIN E BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si autoritet kontraktor, të shpallë brenda datës 20 dhjetor 2011, në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin e fituesit dhe njoftimin e kontratës së nënshkruar, për tenderin, me objekt "Blerje *software*-i për sistemin e kalimit të të dhënave nga pajisjet fiskale".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.838, datë 6.12.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 4 BASHKI DHE 10 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 4 (katër) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi në vlerën 34 052 300 lekë (tridhjetë e katër milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind lekë), të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Librazhd	2,397,492
2	Bashkia Përrenjas	1,589,203
3	Bashkia Berat	18.404,540
4	Bashkia Fushë-Arrëz	1,032,678
5	Komuna Grabian	940,000
6	Komuna Q. Bulgarec	455,425
7	Komuna Krutje	5,452,800
8	Komuna Karine (Peqin)	195,050
9	Komuna Liqenas	33,000
10	Komuna Fushë-Bulqizë	132,000
11	Komuna Cukalat	90,750
12	Komuna Allkaj	328,125
13	Komuna Levan	1,470,987
14	Komuna Farkë	1,530,250
	Shuma	**34,052,300**

VENDIM
Nr.839, datë 6.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES SË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 26.6.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, si autoritet kontraktor, për të përfunduar, brenda datës 20 dhjetor 2011, procedurat e prokurimit publik, me objekt "Hartimi i projektzbatimit për përshtatjen e godinës së ish-Institutit të Kërkimeve Zooteknike në godinë të Dhomës Administrative". Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.
2. Ngarkohen Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.841, datë 6.12.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË SHARRËS, FAZA III, NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Sharrës, faza III, në Bashkinë e Tiranës.
2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 4 107 (katër mijë e njëqind e shtatë) m^2 tokë truall, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.
3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen është 9 721 269 (nëntë milionë e shtatëqind e njëzet e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale do të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 4 107 (katër mijë e njëqind e shtatë) m^2 tokë truall, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAT QË DO TË SHPRONËSOHEN "PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË SHARRËS FAZA III", NË BASHKINË E TIRANËS

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja m^2	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Nr. i pasurisë
1	Time Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
2	Hamdi Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
3	Naze Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
4	Sofije Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
5	Enver Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
6	Zyhdi Muça	98.56	2367	233 292	Certifikatë	127/23
7	Bashkim Gjuzja	24.64	2367	58323	Certifikatë	127/23
8	Danjela Gjuzja	24.64	2367	58323	Certifikatë	127/23
9	Aqif Gjuzja	24.64	2367	58323	Certifikatë	127/23
10	Brunilda Gjuzja	24.64	2367	58323	Certifikatë	127/23
11	Vane Muça	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
12	Rakibe Shkreta	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
13	Nezir Muça	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
14	Qefsere Zeneli	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
15	Sherife Brari	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
16	Qamil Muça	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
17	Bajram Muça	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
18	Mynevere Meqemeja	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
19	Maliq Muça	123.09	2367	291 354	Certifikatë	127/21
20	Abdulla Zeneli	436.41	2367	1 032 982	Certifikatë	127/21
21	Ervin Zeneli	436.41	2367	1 032 982	Certifikatë	127/21
22	Shaban Muka	436.41	2367	1 032 982	Certifikatë	127/21
23	Ile Lamuça	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
24	Sofije Lamuça	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
25	Xhelal Muça	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
26	Sanije Hyka	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
27	Ramiz Muça	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
28	Asllan Muça	142.87	2367	338 173	Certifikatë	127/19
29	Qanie Muça	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
30	Bedri Muça	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
31	Nexhmije Karaj	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
32	Sanije Xhepa	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
33	Bujar Muça	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
34	Agron Muça	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
35	Arben Muça	20.4	2367	48 287	Certifikatë	127/19
	Totali	**4107**		**9 721 269**		

VENDIM
Nr.844, datë 6.12.2011

PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHTESË NJËSISË BASHKIAKE NR.2 TIRANË, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË VIKTIMAVE GENC MEHMET SPAHIU, FLORIDA NIKO SPAHIU DHE JONA GENC SPAHIU, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË CEREMONISË MORTORE TË VIKTIMAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, njësisë bashkiake nr.2, Tiranë t'i akordohet fondi financiar shtesë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së viktimave Genc Mehmet Spahiu, Florida Niko Spahiu dhe Jona Genc Spahiu, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore të viktimave.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut Tiranë dhe njësia bashkiake nr.2 Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.846, datë 6.12.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "VORA BY-PASS", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vora by-pass", Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën e bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 7 037 (shtatë mijë e tridhjetë e shtatë) m^2, tokë arë, me vlerë 3 982 942 (tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e

nëntëqind e dyzet e dy) lekë, dhe objekt (magazinë), me vlerë 2 061 861 (dy milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 044 803 (gjashtë milionë e dyzet e katër mijë e tetëqind e tre) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 312 000 (treqind e dymbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimeve, prej 6 044 803 (gjashtë milionë e dyzet e katër mijë e tetëqind e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2011, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Shpronësimi të fillojë më 6.12.2011 dhe të përfundojë më 30.12.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Lidhur me objektin, pronari i tij do të likuidohet pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit, si dhe pasi të ketë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, pranë DPRR-së.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I MBIKALIMIT TË VORËS

Nr.	Pronari			Zona	Nr. i pas.	Sip. m^2	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	**Atësia**	**Mbiemri**							
1	Hasime	Bajram	Lamaj	2726	89/77	1190	Arë	566	673540	Konf nga ZRPP-ja
2	"Al Rexhina" sh.p.k.			2726	89/76	1060	Arë	566	599960	Konf nga ZRPP-ja
3	Sulejman	Ali	Muça	2726	89/51	1089	Arë	566	616374	Konf nga ZRPP-ja
4	Muharrem	Ali	Muça	2726	89/52	1133	Arë	566	641278	Konf nga ZRPP-ja
5	Sami	Osman	Muça	2726	89/110	1060	Arë	566	599960	Konf nga ZRPP-ja
6	Bujar	Osman	Muça	2726	89/111	1005	Arë	566	568830	Konf nga ZRPP-ja
7	Shaban	Osman	Muça	2726	89/112	500	Arë	566	283000	Konf nga ZRPP-ja
8	Ilmi		Haxhiu	2726			Magazinë		2061861	Plotësim dokumentacioni
	Shuma					**7037**			**6044803**	

VENDIM
Nr.847, datë 6.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PËR OBJEKTET E INVESTIMIT TË FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË, PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e njësive të qeverisjes vendore, bashki/komuna, si autoritete kontraktore që, brenda datës 10 dhjetor 2011, të përfundojnë procedurat e prokurimit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve të shërbimit parësor, nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2011, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe njoftimi i kontratës së lidhur.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, njësitë e qeverisjes vendore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
LISTA NR.6. PROJEKTET PËR FINANCIM

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
çelur me shkresën nr.16021/1, datë 17.8.2011, nga Ministria e Financave, mbështetur në vendimin e KZHR nr.5, datë 27.7.2011 dhe me vendimin nr.6, datë 14.9.2011 "Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 27.7.2011 të KZH rajoneve

Ministria e Shëndetësisë, viti 2011 në lekë

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kod institucioni	Emri i institucionit	Vlera e plotë	Debiti për vitin 2011	Emërtimi i projektit
1	2	3	4	5	6	7
305	13	2305001	Komuna Lumas	1.500.000	1.130.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Bardhaj, komuna Lumas
304	13	2304001	Komuna Otllak	1.500.000	1.129.694	Ndërtim ambulance Al në fshatin Lapardha 1, komuna Otllak
304	13	2304001	Komuna Otllak	1.500.000	1.150.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Dushnik, komuna Otllak
309	13	2309001	Komuna Vertop	1.500.000	1.150.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Vodicë, komuna Vertop
747	13	2747001	Komuna Gjerbez	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Strafickë, komuna Gjerbez
745	13	2745001	Komuna Bogovë	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Nishovë, komuna Bogovë
743	13	2743001	Komuna Çepan	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Zaberzan, komuna Çepan
367	13	2367001	Komuna Gjepalaj	1.500.000	1.140.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Hardhishtë, komuna Gjepalaj
367	13	2367001	Komuna Gjepalaj	4.000.000	904.280	Ndërtim i QSH T1 në fshatin Gjepalaj komuna Gjepalaj
366	13	2366001	Komuna Xhafzotaj	1.500.000	1.140.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Pejze, komuna Xhafzotaj
368	13	2368001	Komuna Katund i Ri	3.000.000	2.300.000	Ndërtim i QSH T2 në fshati Qerret, komuna Katund i Ri
368	13	2368001	Komuna Katund i Ri	1.500.000	1.140.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Bisht Kamëz, komuna Katund i Ri
524	13	2524001	Komuna Cudhi	1.000.000	760.0O0	Ndërtim amb. A2 në fshatin Shqezë, komuna Cudhi
522	13	2522001	Komuna Bubq	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Mazhe e Madhe, komuna Bubq
315	13	2315001	Komuna F. Bulqizë	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Dushaj, komuna F. Bulqizë
317	13	2317001	Komuna Ostren	3.200.000	1.220.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Ostren i madh, komuna

						Ostren
647	13	2647001	Komuna Baz	1.300.000	1.252.215	Ndërtim amb. A2+çati në fshatin Bashkim, komuna Baz
396	13	2396001	Komuna Shalës	4.000.000	2.890.408	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Shalës, komuna Shalës
391	13	2391001	Komuna Labinot Mal	1.000,000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Lamolle, komuna Labinot Mal
383	13	2383001	Komuna Gostimë	3.350.000	1.270.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Shtermen, komuna Gostime
588	13	2588001	Komuna Hotolisht	3.000.000	1.140.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Hotolisht, komuna Hotolisht
420	13	2420001	Komuna Kurjan	1.000.000	570.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Ngjecan komuna Kurjan
411	13	2411001	Komuna Libofsh	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Adriatik
423	13	2423001	Komuna Cakran	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Hambar komuna Cakran
413	13	2413001	Komuna Topoje	3.000.000	1.140.000	Ndërtim i QSH T2 në fshatin Topoje komuna Topoje
419	13	2419001	Komuna Zharez	1.500.000	570.000	Ndërtim ambulance Al në fshatin Beline, komuna Zharez
129	13	2129001	Bashkia Lushnjë	2.300.000	875.000	Rikonstruksion i ambulancës në fshatin Saver të qytetit të Lushnjës
129	13	2129001	Bashkia Lushnjë	487.000	373.600	Rikonstruksion i ambulancës në lagjen "Sarave" të qytetit të Lushnjës
129	13	2129001	Bashkia Lushnjë	770.000	594.000	Rikonstruksion i ambulancës në lagjen "Gafur Muço" Lushnjë
610	13	2610001	Komuna Rremas	1.500.000	601.706	Ndërtim ambulance A1 në fshatin Adriatik, Komuna Rremas
638	13	2638001	Komuna Fratar	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Gadurovë, komuna Fratar
639	13	2639001	Komuna Kute	2.500.000	955.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Kute, komuna Kute
448	13	2448001	Komuna Antigone	4.000.000	1.515.000	Ndërtim i QSH T2+çati në lagjen "Asim Zeneli" komuna Antigone
452	13	2452001	Komuna Dropull Poshtë	4.000.000	1.515.000	Ndërtim i QSH T2+çati në fshatin Dervican, komuna Dropull Poshtë
446	13	2446001	Komuna Odrie	1.000.000	760.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshati Odrie, Komuna Odrie
447	13	2447001	Komuna Lunxhëri	1.500.000	570.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Valare, komuna Lunxhëri
782	13	2782001	Komuna Krahës	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Allkomemaj, komuna Krahës
697	13	2697001	Komuna Petran	1.600.000	702.200	Rikonstruksion i QSH-së në fshati Qilarishte, komuna Petran
695	13	2695001	Komuna Frashër	1.000.000	570.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Gostivisht, komuna Frashër
691	13	2691001	Komuna Qendër	1.500.000	607.514	Rikonstruksion i QSH në fshatin Kosine, komuna Qendër
509	13	2509001	Komuna Qendër	1.500.000	1. 140.000	Ndërtim amb. Al në Shamoll, komuna Qendër
706	13	2706001	Komuna Çerravë	2.500.000	1.443.741	Rikonstruksion i QSH në fshatin Bllace, komuna Çerravë
701	13	2701001	Komuna Udenisht	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në lagjen "Pole", komuna Udenisht
704	13	2704001	Komuna Trebinjë	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Trebinjë, komuna Trebinjë
337	13	2337001	Komuna Hoçisht	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Eçmenik, komuna Hoçisht
485	13	2485001	Komuna Qendër	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Taç Poshtë, komuna Qendër
552	13	2552001	Komuna Kalis	1.300.000	1.030.000	Ndërtim amb. A2+çati në fshatin Pralisht, komuna Kalis
540	13	2540001	Komuna Malzi	1.300.000	1.030.000	Ndërtim amb. A2+çati në fshatin Shtane, komuna Malzi
549	13	2549001	Komuna Surroj	2.280.000	1.601.977	Rikonstruksion i ambulancave në fshatrat Çimanak, Fus… në komunën Surroj
544	13	2544001	Komuna Shtiqen	840.000	652.000	Rikonstruksion i ambulancave në fshatrat Gjallicë, Lum… në Komunën Shtiqen
117	13	2117001	Bashkia Krumë	1.000.000	1.000.000	Ndërtim amb. A2 në bashkinë Krume
823	13	2823001	Komuna Fierzë	2.000.000	1.520.000	Ndërtim amb. A1+çati në fshatin Dushaj, komuna Fierzë
820	13	2820001	Komuna Tropojë	1.300.000	1.000.000	Ndërtim amb. A2+çati në fshatin Shkëlzen, komuna Tropojë
570	13	2570001	Komuna Zejmen	3.000.000	1.370.317	Ndërtim i QSH T2 në fshatin Spiten, komuna Zejmen
560	13	2560001	Komuna Milot	1.500.000	570.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Mal Bardhë, komuna Milot
560	13	2560001	Komuna Milot	1.500.000	570.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Mal Milot, komuna Milot
133	13	2133001	Bashkia Rrëshen	1.500.000	570.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Malaj, lagjja "Valce", bashkia Rrëshen
133	13	2133001	Bashkia Rrëshen	1.000.000	760.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Tarazh, bashkia Rrëshen
164	13	2164001	Bashkia Rubik	545.000	413.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Rasfik, bashkia Rubik
669	13	2669001	Komuna Kthelle	1.500.000	570.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Rrushkull, komuna Kthelle
669	13	2669001	Komuna Kthelle	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Shebe, komuna Kthelle
670	13	2670001	Komuna Selitë	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Zajse, komuna Selite
668	13	2668001	Komuna Fan	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Bisake, komuna Fane
767	13	2767001	Komuna Dajç	1.000.000	1.000.000	Rikonstruksion i QSH-së në komunën Dajç
768	13	2768001	Komuna Ana e Malit	650.000	500.000	Rikonstruksion të ambulancave në fshatrat Obot+VeIin… (nga përmbytjet), komuna Ana e Malit
764	13	2764001	Komuna Bushat	650.000	500.000	Rikonstruksion i ambulancave në fshatrat Bushat qend… Jushit (nga përmbytjet), komuna Bushat
760	13	2760001	Komuna Gur i Zi	200.000	151.000	Rikonstruksion i amb. në fshatin Kuc (nga përmbytjet), komuna Gur i Zi
761	13	2761001	Komuna Vlg-Mnele	3.000.000	1.221.459	Rikonstruksion i QSH-së në Vig-Mnele, komuna Vig-Mnele
755	13	2755001	Komuna Postribë	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Myselim, komuna Postribe
715	13	2715001	Komuna Qerret	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Vrith, komuna Qerret

722	13	2722001	Komuna Qaf Mali	2.000.000	1.515.000	Ndërtim amb. Al+çati në fshatin Kryezi, komuna Qafë Mali
628	13	2628001	Komuna Shkrel	1,500,000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në e fshati Çekdedaj, komuna Shkrel
625	13	2625001	Komuna Qendër	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Bogiq-Palvar komuna Qendër
843	13	2843001	Komuna Vllahinë	4.000.000	2.691.318	Rikonstruksion i QSH-së në Vllahinë, komuna Vllahinë
843	13	2843001	Komuna Vllahinë	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Gernec, komuna Vllahinë
845	13	2845001	Komuna Sevaster	3.000.000	1.705.000	Rikonstruksion i QSH-së në fshatin Sevaster, komuna Sevaster
737	13	2737001	Komuna Aliko	1.000.000	760.000	Ndërtim amb. A2 në fshatin Neohor, komuna Aliko
735	13	2735001	Komuna Markat	3.000.000	1.140.000	Ndërtim i QSH T2 në fshatin Markat, komuna Markat
101	13	2101001	Bashkia Tiranë	4.000.000	3.090.000	Ndërtim i QSH Tl në Njësinë Bashkiake nr.6, Tiranë
795	13	2795001	Komuna Petrelë	5.000.000	2.115.000	Rikonstruksion i QSH-së në Daias, komuna Petrelë
805	13	2805001	Komuna Zall-Herr	1.500.000	1.140.000	Ndërtim amb. Al në fshatin Çerkezë, komuna ZaIl-Herr
119	13	2119001	Bashkia Rrogozhinë	4.500.000	3.590.571	Rikonstruksion i QSH-së në Q. Rrogozhinë, bashkia Rrogozhinë

VENDIM
Nr.849, datë 14.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 2.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2011, PËR BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 "Për financimin, nga Buxheti i Shtetit, të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave", të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në pikën 1 të vendimit nr.160, datë 2.3.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "a" shifra 31 632 000 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë bëhet 30 478 175 (tridhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

2. Në nënndarjen "i" të shkronjës "a" shifra 16 758 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë bëhet 15 604 175 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

3. Në shkronjën "b" shifra 26 220 000 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e njëzet mijë) lekë bëhet 26 158 675 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

4. Në nënndarjen "i" të shkronjës "b", shifra 21 660 000 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë bëhet 21 598 675 (njëzet e një milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

5. Në shkronjën "c" shifra 25 878 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë bëhet 25 816 675 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

6. Në nënndarjen "i" të shkronjës "c", shifra 4 332 000 (katër milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë) lekë bëhet 4 270 675 (katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

7. Në shkronjën "ç" shifra 16 270 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë bëhet 17 546 475 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

8. Në nënndarjen "i" të shkronjës "ç", shifra 3 762 000 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë bëhet 2 693 975 (dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

9. Në nënndarjen "ii" të shkronjës "ç", shifra 8 508 000 (tetë milionë e pesëqind e tetë mijë) lekë bëhet 10 852 500 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.851, datë 14.12.2011

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHTESË TË PROJEKTIT "SIGURIA E DIGAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozim e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit "Siguria e digave", nëpërmjet një huaje prej 15 500 000 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës _____, 201_, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), për qëllimin e sigurimit të financimit shtesë për Projektin Fillestar (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord, si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e dhëna atyre në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Huaja

2.01. Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit hua, në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro (€15,500,000), siç kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një Këmbimi valutor, në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (Huaja), për të ndihmuar për financimin e projektit të përshkruar në programin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me seksionin IV të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi është e barabartë me një të tretën e një për qind (0.25%) të shumës së huas.

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi është në një normë të barabartë me normën referuese për monedhën e huas, plus diferencën e ndryshueshme, me kusht që pas një konvertimi të të gjithë ose një pjese të shumës së principalit të huas, interesi i pagueshëm nga huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit për këtë shumë, do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë shumë e balancës së tërhequr të huas mbetet e papaguar, kur kërkohet dhe ky mospagim vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

2.06 Shuma e principalit të huas shlyhet në përputhje me programin e amortizimit në programin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë ndonjë prej konvertimeve të mëposhtme të çmimeve të Huas, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të duhur të borxhit: i) një ndryshim të monedhës së Huas të të gjithë ose një pjese të shumës së principalit të huas, të tërhequr ose të patërhequr, për një monedhë të aprovuar; dhe ii) një ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshme për të gjithë ose një pjesë të shumës së principalit të huas të tërhequr dhe të papaguar nga një normë e ndryshueshme për një normë të caktuar, ose anasjelltas, ose nga një normë të ndryshueshme në bazë të një diference të ndryshueshme për një normë të ndryshueshme në bazë të një diference të caktuar.

b) Çdo konvertim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni që pranohet nga Banka, konsiderohet "Konvertim", siç përcaktohet në kushtet e përgjithshme, dhe kryhet në përputhje me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe udhëzimet e konvertimit.

Neni 3
Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit dhe programit. Për këtë qëllim, Huamarrësi realizon projektin nëpërmjet njësisë zbatuese të projektit, në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjen e projektit.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton se projekti kryhet në përputhje me dispozitat e programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Mjetet ligjore të bankës

4.01. Rasti shtesë i pezullimit përfshin rastin kur legjislacioni i njësisë zbatuese të projektit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, tërhequr ose hequr dorë, në një mënyrë që ndikon negativisht dhe materialisht tek aftësia e njësisë zbatuese të projektit për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së projektit.

4.02 Afati i bashkëfinancimit për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së bashkëfinancimit të BERZH-it, i përcaktuar në paragrafin 7 (a) të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, është data 1 korrik 2012.

Neni 5
Hyrja në fuqi, përfundimi

5.01 Kushti shtesë për hyrjen në fuqi përfshin rastin kur Marrëveshja shtesë është nënshkruar në emër të Huamarrësit dhe njësisë për zbatimin e projektit.

5.02 Çështjet ligjore shtesë përfshijnë rastin kur marrëveshja shtesë është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave nga Huamarrësi dhe nga njësia për zbatimin e projektit dhe është ligjërisht detyruese për Huamarrësin dhe njësinë e zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati për hyrjen në fuqi është data që bie nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Përfaqësuesi, adresat

6.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.
6.02. Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Nr.4, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Faks: 355-4222-8494
6.03. Adresa e Bankës është:
International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa kabllore:	Teleks:	Faks:
INTBAFRAD	248423(MCI) ose	1-202-477-6391
Washington, D.C.	64145(MCI)	

Rënë dakord në _____, _____, në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

SHQIPËRIA

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

PROGRAMI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit janë: i) të kontribuojë në mbrojtjen e digave hidroelektrike të kaskadave të lumit Drin dhe Mat në territorin e Huamarrësit; dhe ii) të përmirësojë efektivitetin operacional të digave të lartpërmendura hidroelektrike dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në tregun rajonal.

Projekti përfshin fazën e pestë të programit dhe përbëhet nga projekti fillestar.

PROGRAMI 2
REALIZIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Masat zbatuese

A. Marrëveshja shtesë

1. Për të lehtësuar realizimin e projektit, Huamarrësi do të vërë në dispozicion të Njësisë së Zbatimit të Projektit të ardhurat e huas, sipas një marrëveshjeje shtesë ndërmjet Huamarrësit dhe Njësisë së Zbatimit të Projektit, në bazë të kushteve dhe afateve të aprovuara nga Banka (marrëveshja shtesë).

2. Huamarrësi ushtron të drejtat e tij sipas Marrëveshjes shtesë, me qëllim që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Bankës dhe të përmbushë qëllimet e huas. Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk transferon, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë nga Marrëveshja shtesë ose ndonjë prej dispozitave të saj.

B. Antikorrupsion

Huamarrësi garanton se projekti është realizuar në përputhje me dispozitat e udhëzimeve

Seksioni II. Raporti dhe vlerësimi mbi monitorimin e projektit

A. Raportet e projektit

1. Huamarrësi monitoron dhe vlerëson, dhe merr masa që NJZP-ja të monitorojë dhe të vlerësojë ecurinë e projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të rënë dakord me Bankën. Çdo raport projekti mbulon periudhën e një semestri kalendarik, dhe i jepet Bankës jo më vonë se dy (2) javë pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Për qëllime të seksionit 5.08 (c) të kushteve të përgjithshme, raporti mbi realizimin e projektit dhe plani përkatës i kërkuar sipas këtij seksioni do t'i jepet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj para datës së përfundimit.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditet

1. Huamarrësi merr masa që NJZP-ja të administrojë një sistem të menaxhimit financiar, në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Huamarrësi merr masa që NJZP-ja të përgatisë dhe t'i japë bankës jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituara për projektin që mbulojnë semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi merr masa që NJZP-ja të sigurojë auditimin e pasqyrave financiare, në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo audit i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat e audituara financiare për çdo periudhë të tillë i jepen Bankës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

Seksioni III. Prokurimi

A.Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet. Të gjitha mallrat dhe punimet e kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga të ardhurat e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të prokurimit dhe dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga të ardhurat e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në Seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentëve dhe dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Banka, të kontratave të caktuara, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose sipas rastit, seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentëve.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave dhe punimeve

1. Ofertimi konkurrues ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e ofertimit konkurrues ndërkombëtar

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave dhe punimeve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, përveç ofertimit konkurrues ndërkombëtar, që mund të përdoren për mallrat dhe punimet. Plani i prokurimit përcakton rrethanat, sipas të cilave mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Blerje

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Tabela e mëposhtme përcakton metodat e prokurimit, përveç përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto, që mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit përcakton rrethanat, sipas të cilave mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja e bazuar në cilësi
b) Përzgjedhja e kostos më të ulët
c) Përzgjedhja e burimit të vetëm të firmave konsulente
d) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve
e) Procedurat e përcaktuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentëve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Të gjitha kontratat u nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave të huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, këtë seksion dhe udhëzimet shtesë që Banka përcakton me njoftim për Huamarrësin (duke përfshirë "Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për Projektet" të muajit maj 2006, të cilat rishikohen herë pas here nga Banka dhe që bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për financimin e shpenzimeve të pranueshme, të përcaktuara në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat e huas (kategoria), alokimin e shumave të huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori. Taksat nuk janë të pranueshme për financimin e të ardhurave të huas.

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1. Mallrat dhe punimet	15,000,000	100%
2. Shërbimet e konsulentëve për zhvillimin hidroenergjetik dhe menaxhimin e ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të projektit	0	100%
3. Tarifa fillestare	39,750	Shuma e pagueshme sipas seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
4. Të paalokuara	460,250	
SHUMA TOTALE	**15,500,000**	

Për qëllime të këtij programi, termi "Shërbimet e konsulentëve për zhvillimin hidroenergjetik dhe menaxhimin e ujit" nënkupton shpenzimet për shërbimet e konsulentëve për studimet, studimet e fizibilitetit, planprojektin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit.

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera përpara datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Data e përfundimit është 30 dhjetor 2016.

PROGRAMI 3
PROGRAMI I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit, të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit (pjesa e këstit). Nëse të ardhurat e huas janë tërhequr plotësisht nga data e parë e pagesës së principalit, shuma e principalit të huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) balancën e tërhequr të huas nga data e parë e pagesës së principalit; me b) pjesën e këstit për çdo datë të pagesës së principalit; kjo shumë e shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të këtij programi, për të cilin zbatohet një këmbim valutor.

Data e pagesës së principalit	Pjesa e këstit (shprehur si përqindje)
Çdo 15 maj dhe 15 nëntor Duke filluar nga data 15 maj 2018 deri në 15 nëntor 2028	4.35%
Më 15 maj 2029	4.30%

2. Nëse të ardhurat e huas nuk janë tërhequr plotësisht nga data e parë e pagimit të principalit, shuma e principalit e huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagimit të principalit, do të përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që të ardhurat e huas janë tërhequr nga data e parë e pagesës së principalit, Humarrësi do të shlyejë balancën e tërhequr të huas nga kjo datë, në përputhje me paragrafin 1 të këtij Programi.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së interesit, shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga Banka, duke shumëzuar

shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një fraksion, numëruesi i të cilit është pjesa fillestare e kështit të përcaktuar në tabelën në paragrafin 1 të këtij programi për datën e lartpërmendur të pagesës së principalit (pjesa e kështit fillestar) dhe emërtuesi i të cilit është shuma e të gjitha pjesëve të mbetura të kështit fillestar për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date, ato shuma të shlyeshme që duhet të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të këtij Programi për të cilin zbatohet këmbimi valutor.

3. a) Shumat e huas të tërhequr brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo date të pagesës së principalit, për qëllime vetëm të llogaritjes së shumave të principalit, të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, do të trajtohen si të tërhequra dhe të papaguara në datën e dytë të pagesës së principalit, pas datës së tërheqjes dhe do të jenë të shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon me datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem faturimi në datën e kërkueshme, sipas të cilit lëshohen faturat në ose pas datës përkatëse të pagimit të principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk zbatohen më për tërheqjet e bëra pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij programi, pas një këmbimi valutor të të gjithë ose një pjese të balancës së tërhequr të huas për një valutë të aprovuar, shuma e konvertuar në monedhën e aprovuar që është e shlyeshme në çdo datë të pagimit të shlyerjes që zhvillohet gjatë periudhës së konvertimit, përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të kuotimit menjëherë përpara konvertimit, ose me: i) normën e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e aprovuar, të pagueshme nga Banka sipas transaksionit mbi sigurimin e investimeve në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse Banka përcakton në përputhje me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të normës për shlyerjen e interesit.

5. Nëse balanca e huas së tërhequr është shprehur në më shumë se një monedhë huaje, dispozitat e këtij programi zbatohen veçmas për shumën e shprehur në çdo monedhë huaje, në mënyrë që të planifikohet një program i veçantë amortizimi për çdo hua të tillë.

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizimet

1. “Komiteti shqiptar i digave të mëdha” nënkupton komitetin e digave të mëdha të huamarrësit, të krijuar në bazë të ligjit nr.8681, të datës 11 shkurt 2000 “Mbi mbrojtjen, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave të mëdha, të ndryshuar.

2. “Udhëzimet antikorrupsion” nënkupton “Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BERZH-it dhe kreditë dhe grandet e SHZHN-së”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011.

3. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin (iv) të programit 2 të kësaj marrëveshjeje.

4. “Bashkëfinancues” nënkupton bashkërisht Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe sekretariatin e shtetit për çështjet ekonomike të Zvicrës. “Bashkëfinancues” nënkupton individualisht ndonjë prej bashkëfinancuesve.

5. “Bashkëfinancim” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 16 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, sa më poshtë: a) një shumë prej 12,700,000 euro që duhet të ofrohet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit; dhe b) një shumë të barasvlershme deri në 10 milionë US$ që duhet të ofrohet nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit.

6. “Marrëveshje bashkëfinancimi” nënkupton bashkërisht: a) Marrëveshjen e Bashkëfinancimit të BERZH-it që duhet të lidhet ndërmjet njësisë për zbatimin e projektit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që parashikon një shumë prej 12,700,000 eurosh, e cila duhet të ofrohet nga

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për të ndihmuar në lidhje me financimin e projektit; dhe b) Marrëveshjen e bashkëfinancimit SECO të datës 24 maj 2011, të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës, që parashikon një shumë të barasvlershme deri në 10 milionë US$ që duhet të ofrohet nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës, për të ndihmuar në lidhje me financimin e Projektit.

7. "Udhëzimet e konsulentëve" nënkupton "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të publikuara nga Banka në maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

8. "Plan institucional i sigurisë së digave" nënkupton planin që duhet të miratohet nga njësia e zbatimit të projektit, i cili trajton çështje të sigurisë së digave në kaskadat e lumit Drin dhe Mat dhe mënyrat për rregullimin e tyre.

9. "Plan i gatishmërisë në raste emergjencash" nënkupton planin që duhet të përgatitet nga njësia e zbatimit të projektit, i pranueshëm për bankën, i cili përcakton rolet e palëve përgjegjëse, kur mosfunksionimi i digës konsiderohet i afërt ose kur rrjedha e pritshme operacionale rrezikon jetën, pronat ose operacionet ekonomike në rrjedhën e poshtme, të cilat varen nga nivelet e rrjedhës së lumit.

10. "Plan i menaxhimit mjedisor" nënkupton planin e miratuar nga Huamarrësi më 15 maj 2008, i pranueshëm për Bankën, që përbëhet nga grupi i masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale, të cilat duhet të merren për të eliminuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale, për t'i eliminuar ose zvogëluar në nivele të pranueshme, si dhe masat e nevojshme për realizimin e këtyre masave.

11. "Kushtet e përgjithshme" nënkupton "Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, kushtet e përgjithshme për huat", të datës 31 korrik 2010.

12. "Marrëveshje fillestare financimi" nënkupton Marrëveshjen e financimit për projektin e sigurisë së digave ndërmjet huamarrësit dhe Bankës të datës 2 korrik 2008, të ndryshuar, deri dhe duke përfshirë datën e kësaj Marrëveshjeje (kredia nr.4480).

13. "Projekt fillestar" nënkupton projektin e përshkruar në marrëveshjen fillestare të financimit.

14. "Panel ekspertësh" nënkupton panelin me të paktën 3 ekspertë në fusha të ndryshme teknike që lidhen me aspekte të sigurisë të digave të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës, Shkopetit dhe Ulzës, të krijuar në bazë të termave të referencës të pranueshme për Bankën dhe përgjegjës për rishikimin dhe udhëzimin e Huamarrësit dhe njësisë për zbatimin e projektit mbi çështje të lidhura me sigurinë e digave dhe aspekte të tjera të rëndësishme të digave, strukturave të tyre përkatëse, zonave të ujëmbledhësve, zonave rreth rezervuarit dhe zonave në rrjedhën e poshtme.

15. "Udhëzimet e prokurimit", "Udhëzimet: Prokurimi sipas huave të BERZH-it dhe kredive të FZHN-së" të publikuara nga Banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

16. "Plan prokurimi" nënkupton planin e prokurimit të Huamarrësit për Projektin, të datës 19 tetor 2011 dhe të përmendur në paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve të konsulentëve, të cilat përditësohen herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mësipërm.

17. "Program" nënkupton programin e planifikuar për të mbështetur Komunitetin e Energjisë për Europën Juglindore, të përcaktuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të datës 23 tetor 2005, nëpërmjet një serie huash të programit që mund të përshtaten për shtetet anëtare të Bankës në Europën Juglindore.

18. "Njësi për zbatimin e projektit" ose "NJZP" nënkupton Korporatën Energjetike Shqiptare, KESH, një shoqëri e pavarur e krijuar në bazë të legjislacionit të njësisë për zbatimin e projektit.

19. "Legjislacion i njësisë për zbatimin e projektit" nënkupton ligjin e huamarrësit nr.7926, datë 20 prill 1995, të ndryshuar.

20. "Njësi për menaxhimin e projektit" nënkupton njësinë e ngarkuar për menaxhimin e zbatimit të projektit, e krijuar pranë njësisë për zbatimin e projektit.

21. "Marrëveshje shtesë" nënkupton marrëveshjen e përmendur në seksionin I.B të programit 2 të kësaj Marrëveshje, sipas të cilës Huamarrësi do të vërë të ardhurat e huas në dispozicion të njësisë për zbatimin e projektit.

Shtojca 3: Letër shtesë e marrëveshjes së huas
Letër shtesë

SHQIPËRIA

_____, 2011

European Bank for Reconstruction
and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Lënda: Huaja nr. _____-AL
(Komuniteti i energjisë i programit të Europës Juglindore–Financim shtesë për projektin e sigurisë së digave)
Neni VI i kushteve të përgjithshme
Të dhëna financiare dhe ekonomike

Të nderuar zonja dhe zotërinj:

Në lidhje me Marrëveshjen e huas të kësaj date ndërmjet Shqipërisë (shteti anëtar) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) që ofron një hua (huaja) për projektin e mësipërm dhe kushtet e përgjithshme (kushtet e përgjithshme) të zbatueshme për Marrëveshjen e Huas, po ju shkruaj në emër të shtetit anëtar për të parashtruar, sa më poshtë:

1. Ne kuptojmë dhe biem dakord që, për qëllimet e seksionit 6.01 të kushteve të përgjithshme, shtetit anëtar i është kërkuar nga Banka që të raportojë "borxhin e jashtëm afatgjatë" (të përcaktuar në manualin e sistemit të raportimit të debitorëve të Bankës Botërore, të muajit janar 2000 (RDBB)), në përputhje me RDBB-në dhe në veçanti, të njoftojë Bankën për "detyrimet e reja të huas" (siç përcaktohet në RDBB jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të semestrit, gjatë të cilit ka lindur borxhi, dhe të njoftojë Bankën për "transaksionet sipas huave" (të përcaktuar në RDBB) një herë në vit, jo më vonë se data 31 mars të vitit pas vitit të mbuluar nga raporti.

2. Ne përfaqësojmë se asnjë barrë (e përcaktuar në kushtet e përgjithshme), përveç atyre të përjashtuara sipas paragrafit (c) të seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme, nuk ekziston për asetet publike (të përcaktuara në kushtet e përgjithshme), si garanci për borxhin e jashtëm (të përcaktuar në kushtet e përgjithshme). Nuk ekziston asnjë mospagim në lidhje me borxhin e jashtëm (të përcaktuar në RDBB). Sipas gjykimit tonë, në dhënien e huas, Banka mund të mbështetet në përfaqësimet e parashtruara ose t'i referohet kësaj letre.

3. Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj sa më sipër, duke caktuar një përfaqësues të Bankës të autorizuar sipas rregullave, për të nënshkruar në hapësirën e mëposhtme.

Me respekt,

SHQIPËRIA

Nga _____
Përfaqësuesi i autorizuar

Rënë dakord:
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____
Përfaqësuesi i autorizuar

VENDIM
Nr.852, datë 14.12.2011

PËR LEJIMIN E AUTORITETIT SHËNDETËSOR RAJONAL (ASHR), TIRANË, PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT "RIKONSTRUKSIONI I URGJENCËS SË TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR), Tiranë, për përfundimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i Urgjencës së Tiranës", me fond limit 6 562 500 (gjashtë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, pa TVSH, brenda datës 26 dhjetor 2011.

Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.853, datë 14.12.2011

PËR LEJIMIN E BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE DHE TË DREJTORIVE RAJONALE RRUGORE NË QARQE SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e botimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të drejtorive rajonale rrugore në qarqe, si autoritete kontraktore, brenda datës 20 dhjetor 2011, për objektet e caktuara sipas listave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe drejtoritë rajonale rrugore në qarqe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA 1

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve

1. Shërbim me roje civile (Behase, godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve).

LISTA 2

Autoriteti kontraktor: Drejtoritë rajonale rrugore në qarqe

I. Drejtoria Rajonale Rrugore, Shkodër:

1. Mirëmbajtje dimërore rruga Qafë Qele – Pukë (27.5 km);
2. Mirëmbajtje dimërore rruga Pukë - Qafë Mali (30 km);
3. Mirëmbajtje dimërore rruga Qafë Mali - Qafë Shllak (17 km).

II. Drejtoria Rajonale Rrugore, Dibër:

1. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Skuraj - Burrel (40 km)+Ura e Ulzës-Ulëz (3 km);
2. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Burrel - Qafë Buall (30 km);
3. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Qafë Buall - Ura Topojanit (30 km);
4. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Ura e Topojanit - Peshkopi (21 km) + Maqellarë - Doganë Bllatë (4 km);
5. Emergjencë;
6. Emergjencë (Blerje kripe).

III. Drejtoria Rajonale Rrugore, Kukës:

1. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore, aksi rrugor Kukës – Aeroport – Kolosjan - Dajç Reç (Peshkopi);
2. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore, aksi rrugor Kam-Krumë.

VENDIM
Nr.855, datë 14.12.2011

PËR LEJIMIN E BOTIMIT, NË BULETININ E PROKURIMEVE PUBLIKE, TË NJOFTIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE SUBJEKTIT EKONOMIK FITUES NË TENDERIN E ZHVILLUAR ME OBJEKT "NDËRTIMI I SISTEMIT TË RRJETIT IT TË DPM-SË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë së Prokurimit Publik për të botuar, në Buletinin e Prokurimit Publik, njoftimin e lidhjes së kontratës ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si autoritet kontraktor, dhe subjektit ekonomik fitues në tenderin me objekt: "Ndërtimi i sistemit të rrjetit IT të DPM-së".

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.856, datë 14.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT "BLERJE APARATI *ECHO*-JE PORTABËL, PËR SOBIN DHE SHËRBIMIN PARËSOR TË ASHR-SË", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR), Tiranë, të përfundojë brenda datës 26 dhjetor 2011, procedurën e prokurimit me objekt "Blerje aparati *Echo*-je portabël për Sobin dhe shërbimin parësor të ASHR-së", me fond limit 4 583 333 (katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tri mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekësh, pa TVSH.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratës dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.857, datë 14.12.2011

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT MUSTAFA PEPA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin "Mallra dhe shërbime", t'i shtohet fondi prej 1 750 000 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit, në Turqi, të shtetasit Mustafa Pepa.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.858, datë 14.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT NGA MINISTRIA E BRENDSHME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR DISA SHËRBIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, të realizojë, brenda datë 31 dhejtor 2011, procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, të përcaktuara bashkëlidhur këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritete kontraktore, të përmendura në aneks, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS

	Autoriteti kontraktor	**Fondi limit pa TVSH**
I	**Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit *katering*, ndarë në 11 lote**	
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për repartin "Renea"	59,420,065
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës	4,297,139
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Qendrën e Formimit Policor	113,536,233
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Repartin 712 FNSH Tiranë	44,919,433
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Repartin 731 FNSH Shkodër	32,705,484
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Repartin 752 FNSH Fier	28,461,600
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë Tiranë	4,100,149
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Delta Force Vlorë	27,597,041
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier	2,789,042
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Qendrën Spitalore të Burgjeve	3,807,935
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Spitalin Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"	3,664,978
	Total pa TVSH (fondi limit)	325,299,099
II	**Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit për Repartin Poshnje 1030**	**193,294,372**

VENDIM
Nr.859, datë 16.12.2011

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR RRITJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE DHE SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE ME RASTIN E FESTAVE TË FUNDVITIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t'i shtohet fondi prej 4 799 345 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekësh, i cili të përdoret, si më poshtë vijon:

a) 2 299 345 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë, për përballimin e efekteve financiare shtesë nga rritja e pagave të punonjësve të këtij institucioni;

b) 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për shpërblimin e punonjësve të kësaj drejtorie për festat e fundvitit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4363, datë 15.9.2011

PËR SHPENZIMET DHE KOSTON EKONOMIKE, PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË MBLEDHJES SË DETYRIMEVE NGA SUBJEKTET DEBITORE QË KANË PËRFITUAR NGA FONDI KUNDËRPARTI DHE NON PROJEKT GRAND AIDI, TË ARDHURA NGA GRANDET JAPONEZE, PËR SEKTORIN E BUJQËSISË E TË USHQIMT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.868, datë 27.10.2010 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondi kundërparti dhe "Non projekt Grand Aidi", të ardhura nga grandet japoneze për sektorin e bujqësisë e të ushqimit",

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Fondi gjendje prej 17.000.000 lekë të përdoret për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen gjatë procedurave për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore të financuara nga fondi kundërparti dhe "Non projekt Grand Aidi".

2. Fondi gjendje prej 17.000.000 lekë i mbledhur nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, i vitit 2006, duhet të derdhet pjesë-pjesë në Buxhetin e Shtetit në kapitullin VI të MBUMK (të ardhura jashtë limitit), në përputhje me nevojat që do të lindin për mbulimin e shpenzimeve (kostos) të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitore.

3. Për subjektet debitore, të cilat nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale, në mbështetje të kontratës së nënshkruar, kryhet sekuestrimi i mallrave, pajisjeve, linjave të përpunimit ose serrave me ngrohje.

4. Zhvillimi i procedurave të ankandit të kryhet në mbështetje të ligjit "Për ankandin publik" dhe i gjithë fondi i mbledhur nga shitja e tyre do të kalojë në llogari të fondit kundërparti dhe "Non projekt Grand-Aidit".

KREU II
AUTORITETI PËRGJEGJËS

1. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është autoriteti përgjegjës për menaxhimin, organizimin, çmontimin, transportimin, ruajtjen e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje, në pronësi të AZHBR-së.

2. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton me shkrim palën debitore që nuk ka përmbushur detyrimin sipas kushteve të kontratës së lidhur, duke i lënë atij një afat të përcaktuar prej 30 ditësh për fillimin e procedurave për marrjen e sendit.

3. Drejtori i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nxjerr urdhrin për kthimin e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje, në pronësi të AZHBR-së.

4. AZHBR planifikon punën për çmontimin e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje.

KREU III
PËRGATITJA E PROCEDURAVE

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me miratimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ngre komisionin e marrjes në dorëzim të sendeve, i përbërë nga 5 (pesë) përfaqësues, nga të cilët 4 (katër) nga AZHBR- ja, 1 (një) përfaqësues nga MBUMK.

2. Komisioni i marrjes në dorëzim të serrave me ngrohje dhe të linjave të përpunimit kryen mbikëqyrjen e të gjithë procesit të çmontimit, transportimit, magazinimit dhe ruajtjes së sendeve sipas procedurave ligjore në fuqi.

3. Inventarizimi i sendeve do të kryhet nga përfaqësuesit e ngarkuar për kryerjen e këtij shërbimi. Një kopje e procesverbalit të inventarizimit të sendeve do t'u vihet në dispozicion edhe debitorëve.

4. Pas marrjes në dorëzim të sendeve, ato vlerësohen nga ekspertët përkatës të licencuar, të cilët përgatisin raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik sipas standardeve ligjore.

5. Ekspertët e fushës parazgjidhen sipas ligjit me nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

KREU IV
VLERËSIMI I SENDEVE

1. Vlerësimi i mallrave, pajisjeve, linjave të përpunimit ose serrave me ngrohje, kryhet nga ekspertët e fushës duke u bazuar në standardet ligjore në fuqi.

2. Komisioni i marrjes në dorëzim dhe poseduesi i sendit/eve pas vlerësimit, firmosin procesverbalin e gjendjes fizike aktuale të sendit në momentin e marrjes në dorëzim. Procesverbali mbahet në 3 kopje origjinale.

KREU V
RUAJTJA, ÇMONTIMI, TRANSPORTIMI DHE MAGAZINIMI

1. Ruajtja e sendeve, serrave dhe linjave të përpunimit kryhet nga shërbimi i sigurisë së ruajtjes fizike të cilët përzgjidhen sipas procedurave ligjore në fuqi.

2. Subjekti debitor të cilit do t'i merret sendi, nuk duhet të ndryshojë, të dëmtojë apo të zhdukë asnjë pjesë apo aksesorë të objektit në ruajtje, në rast konstatimi ai do të mbajë përgjegjësi sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast se konstatohet mungesë apo ndryshim në sendet e inventarizuara, kjo përgjegjësi do të shtrihet edhe mbi personat që e kanë në posedim.

4. Në rastet kur konstatohet se sendet (serrat me ngrohje apo linjat e përpunimit) janë në proces pune, do të vendoset një afat i arsyeshëm ditësh nga cikli i plotë i përfundimit të përpunimit të prodhimit në proces.

5. Çmontimi i sendeve të kryhet pas inventarizimit dhe vlerësimit të tyre nga specialistët e ngarkuar.

6. Transportimi i mallrave do të kryhet nga mjete të specializuara të cilat do të përzgjidhen sipas procedurave të prokurimit.

7. Magazinimi i tyre do të kryhet në ambientet e zgjedhura për magazinimin e tyre sipas procedurave të prokurimit apo të marrjes me qira.

8. Pas magazinimit të tyre, të zhvillohen procedurat e ankandit sipas ligjit nr.9874, datë 14.2.2008, i ndryshuar me ligjin nr.10 346, datë 4.11.2010 "Për ankandin publik".

KREU VI
DISPOZITA E FUNDIT

1. Për zhvillimin e procedurave të mësipërme, ngarkohen përfaqësuesit e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe përfaqësuesit e ngarkuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për rastet e patrajtuara nga ky udhëzim, për shkak të faktorëve objektivë, me propozim të Drejtorit të AZHBR-së, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, përcakton mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.493, datë 6.10.2011

PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT DYTË, "MASTER PROFESIONAL", PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 4 të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, "Master profesional" për vitin akademik 2011-2012",

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit, për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës për programet e studimit të ciklit të dytë, "Master profesional", për vitin akademik 2011-2012, të cilat pasqyrohen, në total për çdo program studimi, në kolonën E të tabelës nr.1, të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve master profesional, për vitin akademik 2011-2012, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Republika e Kosovës, si dhe i kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës bëhet nga institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) pritëse, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga vetë IAL-të publike, sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.
3. Kandidatët fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, midis aplikantëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, shpallen në përputhje me kuotat e përcaktuara sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.
4. Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në datë 30.10.2011, të dërgojnë kuotat e parealizuara nga regjistrimet e kandidatëve fitues, në mënyrë që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë rishpërndarjen e tyre.
5. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

TABELA NR.1
SHPËRNDARJE E KUOTAVE PËR TROJET, CIKËL II, MASTER PROFESIONAL 2011-2012

A	B	C	D	E	F	G	H
K Universiteti	K ID PROGRAMIT	K EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuota per kandidatet shqiptare nga Kosova	Kuota per kandidatet shqiptare nga Mali i Zi	Kuota per kandidatet shqiptare nga Maqedonia	Kuota per kandidatet shqiptare nga Presheva Bujanovc	Kuota totale per kandidatet shqiptare nga trojet
Universiteti i Tiranës	1	Analizë e Politikës Sociale	1	1		1	3
Universiteti i Tiranës	2	Drejtim dhe Administrim Arsimi	1	1	1		3
Universiteti i Tiranës	3	Punë Sociale			1	1	2
Universiteti i Tiranës	4	Filozofi Praktike dhe Humane	1			1	2
Universiteti i Tiranës	5	Qeverisje dhe Politika Publike		1	1	1	3
Universiteti i Tiranës	6	Këshillim Psikologjik		1	1		2
Universiteti i Tiranës	7	Orientim Profesional	1			1	2
Universiteti i Tiranës	8	Redaktim	1	1	1	2	5
Universiteti i Tiranës	9	Arkivistikë	1		1	1	3
Universiteti i Tiranës	10	Histori (Mësuesi)	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	11	Gjeografi (Mësuesi)	2	1	1	2	6
Universiteti i Tiranës	12	Gjuhë-Letërsi (Mësuesi)	2	2	1	2	7
Universiteti i Tiranës	13	Fizioterapi				1	1
Universiteti i Tiranës	14	Imazheri	1				1
Universiteti i Tiranës	15	Mami	1			1	2
Universiteti i Tiranës	16	Menaxhim Infermieror	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	17	Teknikë Laboratori	1			1	2
Universiteti i Tiranës	18	Shëndet Publik		1	1	1	3
Universiteti i Tiranës	19	Bioteknologji mjedisore	1	1	1	2	5
Universiteti i Tiranës	20	Informatikë Biznesi	2	1	1	1	5
Universiteti i Tiranës	21	Biznes Law	1	1	1	1	4
Universiteti i TiranëS	22	E Drejtë Penale		1	1	1	3
Universiteti i Tiranës	23	E Drejtë Publike	1	1	1		3
Universiteti i Tiranes	24	E Drejtë Civile	1	1	1		3
Univ. Bujqësor i Tiranës	25	Biznes Blegtoral			1	1	2
Univ. Bujqësor i Tiranës	26	Cilësia dhe Siguria Ushqimore	1	1	1	2	5
Univ. Bujqësor i Tiranës	27	Diagnozë Laboratorike	1	1			2
Univ. Bujqësor i Tiranës	28	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Ekonomi dhe Politike Agrare"	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	29	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Financë-Kontabilitet"	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	30	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Menaxhimi Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	31	Klinikë Veterinare			1	1	2
Univ. Bujqësor i Tiranës	32	Mbrojtja e Bimëve dhe Fitofarmacia	1	1			2
Univ. Bujqësor i Tiranës	33	Menaxhim Mjedisi	1	1	1		3
Univ. Bujqësor i Tiranës	34	Teknologjitë e Avancuara në Hortikulture		1	1		2
Univ. Bujqësor i Tiranës	35	Teknologjitë e Kultivimit të Bimëve	1			1	2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	36	Financë-Kontabilitet	2	1	1	1	5
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	37	Gjuhë Angleze	1			1	2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	38	Gjuhë-Letërsi AM		1	1		2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	39	Gjuhë-Letërsi CLAB	1	1	1	1	4
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	40	Marketing	1	1		1	3
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	41	Matematikë-Fizikë				1	1
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	42	Menaxhim	1	1	1	1	4
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	43	Shkenca Sociale AM		1	1	1	3
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	44	Turizëm	1			1	2
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	45	Zhvillim i Integruar Rural		1	1		2
Univ. "A. Moisiu" Durrës	46	Administrim Biznes	1	1	1	1	4
Univ. "A. Moisiu" Durrës	47	Administrim Financiar	1	1		1	3
Univ. "A. Moisiu" Durrës	48	Administrim Publik	1	1	1		3
Univ. "A. Moisiu" Durrës	49	Bankë-Financë	1	1	1	1	4

Univ. "A. Moisiu" Durres	50	Didaktikë		1	1	1	3
Univ. "A. Moisiu" Durres	51	Drejtim SME	1	1			2
Univ. "A. Moisiu" Durres	52	Drejtim Turizmi	1	1			2
Univ. "A. Moisiu" Durres	53	Marketing	1		1	1	3
Univ. "A. Moisiu" Durres	54	Mësimdhenie Gjuhë-Letërsi	1	1	1		3
Univ. Politeknik i Tiranës	55	Automatizim Industrie			1	1	2
Univ. Politeknik i Tiranës	56	Energjitikë				1	1
Univ. Politeknik i Tiranës	57	Inxhinieri e Burimeve Natyrore	1			1	2
Univ. Politeknik i Tiranës	58	Inxhinieri e Materialeve		1	1		2
Univ. Politeknik i Tiranës	59	Inxhinieri Elektronike	1				1
Univ. Politeknik i Tiranës	60	Inxhinieri Gjeodezi	1	1			2
Univ. Politeknik i Tiranës	61	Inxhinieri Gjeofizike					0
Univ. Politeknik i Tiranës	62	Inxhinieri Gjeologjike	1	1	1		3
Univ. Politeknik i Tiranës	63	Inxhinieri Gjeomjedisi				1	1
Univ. Politeknik i Tiranës	64	Inxhinieri Hidroteknike			1		1
Univ. Politeknik i Tiranës	65	Inxhinieri Informatikë	1				1
Univ. Politeknik i Tiranës	66	Inxhinieri Mekanike	1	1	1		3
Univ. Politeknik i Tiranës	67	Inxhinieri Mjedisi		1	1	1	3
Univ. Politeknik i Tiranës	68	Inxhinieri Ndërtimi	1	1	1	2	5
Univ. Politeknik i Tiranës	69	Inxhinieri Tekstile dhe Mode	1			1	2
Univ. Politeknik i Tiranës	70	Inxhinieri Telekomunikacioni			1		1
Universiteti i Tiranës	71	Administrim-Biznes	1	1	1		3
Universiteti i Tiranës	72	Kontabilitet	1	1		1	3
Universiteti i Tiranës	73	Finance	2	2	2	2	6
Universiteti i Tiranës	74	Menaxhim Turizmi				1	1
Universiteti i Tiranës	75	SEE	1	1			2
Universiteti i Tiranës	76	Marketing			1	1	2
Universiteti i Tiranës	77	Administrim-Publik		1	1		2
Universiteti i Tiranës	78	Sisteme informacioni ne Ekonomi	1			1	2
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	79	Mësuesi Matematikë-Fizikë, me profil minor "Informatikë"	1		1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	80	Mësuesi ne Biologji e Kimi	1	1		1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	81	Mësuesi ne Edukim Fizik e Sporte	1	1	1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	82	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi		1	1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	83	Mësuesi ne Histori e Gjeografi	1	1	1		3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	84	Mësuesi ne Histori e Gjeografi me profil minor ne Edukim qytetar	1		1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	85	Mësuesi ne Matematikë e Fizike	1	1	1		3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	86	Mësuesi ne Matematikë e Informatikë		1	1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	87	Mësuesi në Gjuhën Angleze	1	1		1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	88	Mësuesi në Gjuhën Frenge	1	1	1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	89	Mësuesi në Gjuhën Gjermane	1	1		1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	90	Mësuesi në Gjuhën Italiane	1		1	1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	91	Mësuesi në Informatikë me profil minor ne Matematikë	1	1	1		3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	92	Mësuesi në Matematik me profil minor ne Informatikë	1	1		1	3
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	93	Përkthim dhe interpretim ne Gjuhën Gjermane			1		1
Univ. "I. Qemali" Vlorë	94	Administrim Publik	1	1	1	1	4
Univ. "I. Qemali" Vlorë	95	Infermier Kirurg	1	1	1		3
Univ. "I. Qemali" Vlorë	96	Infermier Patolog	2	1	1	1	5
Univ. "I. Qemali" Vlorë	97	Infermier Pediatër		1	1	1	3
Univ. "I. Qemali" Vlorë	98	Shkenca Administrative	1	1	1	1	4
Univ. "I. Qemali" Vlorë	99	Mësuesi në Gjuhë Angleze	1	1		1	3
Univ. "I. Qemali" Vlorë	100	Mësuesi në Gjuhë Italiane	1		1	1	3
Univ. "I. Qemali" Vlorë	101	Mësuesi ne Informatikë	1		1		2
Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5 pika 1 germa "a", dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në

mbledhjen e tij të datës 6.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec Lanabregas" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Lanabregas" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Lanabregas me fuqi 5 Mw", për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.135, datë 6.12.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC LANABREGAS" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", të neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa "d" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të neneve 4 pika 1 germa "g", 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Lanabregas" sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.136, datë 6.12.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2" SHA NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5 pika 1 germa "a" dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec Bisrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Bisrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Bisrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Bistrica 1 me fuqi 22.5 MW dhe hec Bistrica 2 me fuqi 5 MW", për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.137, datë 6.12.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "g", 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.138, datë 7.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË KESH SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a. për periudhën e tretë rregullatore,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore, në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.139, datë 7.12.2011

PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OST SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 9 dhe 11 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 11 të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012- 2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.1, datë 25.6.2011

PËR PËRPARËSITË NË ÇËSHTJET QË OFROHET NDIHMA JURIDIKE PËR VITIN 2011 DHE 2012

Në mbështetje të nenit 10 shkronja "i" të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", me propozimin e Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI:

I. Për ndihmën juridike dytësore, radha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012 të jetë në rend zbritës si më poshtë:

a) çështje gjyqësore me objekt regjistrim lindjeje;

b) çështje gjyqësore për pensione pleqërie, pensione invaliditeti, pensione të parakohshme ose pagesa për personat me aftësi të kufizuar;

c) çështje gjyqësore për heqje zotësie për të vepruar;

ç) çështje gjyqësore për dhënie ndihme ekonomike;

d) çështje gjyqësore për vendosje kujdestarie për fëmijët ose detyrime ushqimore për ta;

dh) çështje gjyqësore të viktimës së dhunës në familje;

e) zgjidhje martese;

ë) çështje gjyqësore për korrigjime të akteve të gjendjes civile;

f) çështje për të cilat Republika e Shqipërisë ka detyrim ligjor për shkak të nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku përcaktohet shprehimisht ofrimi i ndihmës juridike nga shteti shqiptar.

g) rastet e diskriminimit të referuara nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të detyrimeve të memorandumit të bashkëpunimit, të nënshkruar nga KSHNJ dhe KMD.

II. Për ndihmën juridike parësore, radha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012, të jetë në rend zbritës nëpërmjet dhënies së informacionit dhe këshillimit, si më poshtë:

a) hartim dokumentacioni për marrje ndihme ekonomike;

b) hartim dokumentacioni për gjendjen civile;

c) hartim dokumentacioni për të përfituar strehim nga shteti;

ç) hartim dokumentacioni për fushën e sigurimeve shoqërore, humbjen e aftësisë në punë, çështje të marrëdhënieve të punës ose zgjidhje martese.

III. Ndihma juridike parësore jepet nëpërmjet dhënies së informacionit për mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe nëpërmjet dhënies së asistencës, në hartimin e dokumenteve juridike.

Ndihma juridike dytësore jepet nëpërmjet dhënies së këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore dhe para organeve administrative shtetërore.

IV. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike parashikon në marrëveshjet e bashkëpunimit që lidh me organizatat jofitimprurëse mbulimin financiarisht, në mënyrë të pjesshme ose tërësore, të prioriteteve të ndihmës juridike sipas këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Komisionit të marrë masat e nevojshme administrative për respektimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Blegina Kodra

VENDIM
Nr.2, datë 25.6.2011

PËR RREGULLAT E CAKTIMIT TË AVOKATËVE, ZYRAVE TË AVOKATISË DHE ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMËN JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 10 shkronja "c" dhe nenit 20 të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike",

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE
DHE
DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË

VENDOSIN:

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurës që ndiqet për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike parësore dhe ndihmën juridike dytësore, sipas ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike.

Neni 2
Parime

1. Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë caktojnë avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse për ofrimin e ndihmës juridike mbi bazën e parimeve të transparencës, konkurrencës së hapur, ofrimit të shërbimit nga më shumë se një subjekt, profesionalizmit dhe mosdiskriminimit.

2. Caktimi i avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike parësore dhe ndihmën juridike dytësore nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi numerik.

Neni 3
Njoftimi publik

1. Për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike shpall njoftimin publik, i cili duhet të botohet në tri gazeta kombëtare me tirazhin më të madh, për tri ditë rresht, si dhe në faqen e internetit të Komisionit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Njoftimi duhet të përmbajë afatin e dorëzimit të dokumentacionit i cili është 30 ditë pas ditës së fundit të botimit në gazetë, si dhe kërkesat dokumentare sipas neneve 4 dhe 5 të këtij vendimi. Avokati duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e "Përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative" dhe të plotësojë vetë formularin e kërkimit të ndihmës juridike të llojeve të tjera, nëse ka.

Neni 4

Kriteret për avokatët dhe zyrat e avokatisë

1. Avokatët ose zyrat e avokatisë që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike duhet të kenë ushtruar profesionin e avokatisë për të paktën 2 vjet.

2. Avokatët ose zyrat e avokatisë që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike duhet të paraqesin në Komisionin Shtetëror këto dokumente:

a) Kërkesën, në të cilën të paraqitet edhe adresa dhe numri i telefonit.

b) Vërtetim nga dhoma rajonale e avokatisë për përvojën në ushtrimin e profesionit të avokatit për të paktën 2 vjet.

c) *Curriculum Vitae* të avokatit apo avokatëve që përbëjnë zyrat e avokatisë, së bashku me dokumentacionin provues të tyre të noterizuar.

d) Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve financiare ndaj shtetit.

e) Dy rekomandime, në të cilat të përshkruhet njëherësh eksperienca në punë, përvoja në fushën e ndihmës juridike, cilësitë profesionale të kërkuesit, si dhe reputacioni dhe integriteti moral. Rekomandimet paraqiten në një zarf të mbyllur me nënshkrimet e rekomanduesit në pjesën e mbylljes së zarfit.

f) Vërtetim se avokati apo pjesëtarët e zyrës së avokatisë nuk janë deri në kohën e aplikimit në procedim disiplinor nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

3. Avokati apo zyra e avokatisë, të cilit i është zgjidhur kontrata e shërbimit të ndihmës juridike, nuk ka të drejtë të aplikojë.

Neni 5

Zgjedhja e avokatëve

Subjekti i cili me vendim të Komisionit kualifikohet për të përfituar ndihmë juridike ka të drejtë të zgjedhë avokatin në bazë të listës së vënë në dispozicion nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Lista përmban emrat e avokatëve sipas fushës së kualifikimit profesional, si dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. Avokati duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative dhe të plotësojë vetë formularin e kërkimit të ndihmës juridike të llojeve të tjera, nëse ka.

Neni 6

Kriteret për organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike të financuar nga shteti duhet të kenë të paktën 3 vite përvojë në fushën e ofrimit të ndihmës juridike, të jenë të regjistruara dhe të kenë në misionin e tyre ofrimin e shërbimit ligjor.

2. Organizatat jofitimprurëse që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike të financuar nga shteti duhet të paraqesin në Komisionin Shtetëror këto dokumente:

a) Kërkesën, në të cilën të paraqitet edhe adresa dhe numri i telefonit.

b) Dokumentacion që të vërtetojë ushtrimin e veprimtarisë sipas pikës 1 të këtij neni.

c) *Curriculum Vitae* të OJF-së dhe avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike, së bashku me dokumentacionin provues të tyre të noterizuar. Avokatët duhet të kenë përvojë në ushtrimin e profesionit të avokatit për të paktën 2 vjet.

d) Vërtetim të dorëzimit të rregullt të bilancit të fundit vjetor.

dh) Dy rekomandime, në të cilat përshkruhet njëherësh eksperienca në punë, përvoja në fushën e ndihmës juridike, cilësitë menaxheriale, ekspertiza teknike e stafit dhe korrektësia. Rekomandimet paraqiten në një zarf të mbyllur me nënshkrimet e rekomanduesit në pjesën e mbylljes së zarfit.

e) Vërtetim se avokatët nuk janë në procedim disiplinor nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë deri në kohën e aplikimit.

f) Një deklaratë me shkrim për vizionin e tyre për ofrimin e ndihmës juridike.

3. Organizata jofitimprurëse së cilës i është zgjidhur kontrata e shërbimit të ndihmës juridike nuk ka të drejtë të aplikojë.

Neni 7
Shqyrtimi i dokumentacionit

1. Struktura administrative e Komisionit, e ngarkuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, brenda 48 orësh nga mbyllja e afatit të paraqitjes së kërkesave sipas pikës 2 të nenit 3 të këtij vendimi, hap dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesit vetëm për plotësimin e elementeve formalo-juridike sipas këtij vendimi. Në rast se këto elemente kanë të meta, komunikohet menjëherë me kërkuesin për t'i plotësuar ato për një afat jo më shumë se 72 orë.

2. Me përfundimin e afatit, struktura e ngarkuar nga Kryetari i Komisionit paraqet relacion për plotësimin e elementeve formalo-juridike të aplikantëve, si dhe dokumentacionin e plotë për Komisioin Shtetëtor të Ndihmës Juridike.

3. Mbledhja e Komisionit për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse për ofrimin e ndihmës juridike zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së relacionit sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 8
Klasifikimi

1. Komisioni klasifikon me pikë avokatët dhe zyrat e avokatisë që kanë aplikuar për të ofruar ndihmën juridike si më poshtë:

a) eksperiencën në ushtrimin e profesionit të avokatit - 40 pikë;
b) trajnimi në fushën e ofrimit të ndihmës juridike - 20 pikë;
c) reputacioni i mirë dhe mospasja e masës disiplinore - 20 pikë.

2. Komisioni klasifikon me pikë organizatat jofitimprurëse që kanë aplikuar për të ofruar ndihmën juridike, si më poshtë:

a) kapaciteti menaxherial dhe ekspertiza teknike - 20 pikë;
b) eksperiencën e mëparshme në ofrimin e ndihmës juridike - 20 pikë;
c) efikasitetin në menaxhim (çmimi për numër çështjesh ose shërbimesh) - 40 pikë.

3. Komisioni, për kategoritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, zhvillon edhe një intervistë, e cila klasifikohet me 20 pikë në vlerësimin e aplikantëve.

Neni 9
Intervista

1. Komisioni Shtetëror, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i vlerësimit sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij vendimi, zhvillon intervistë me gojë me avokatin, drejtuesin e zyrës së avokatisë dhe drejtuesin e organizatës jofitimprurëse që ka aplikuar.

2. Intervista ka si synim të mundësojë njohjen më të afërt dhe më të besueshme të aftësisë profesionale të kërkuesit, aftësisë në komunikim të tij, si dhe kapacitetit për plotësimin me cilësi dhe në

kohë të detyrave që duhet të kryhen sipas ligjit për ndihmën juridike dhe legjislacionit tjetër në fushat respektive.

3. Në përfundim të kësaj faze, Komisioni plotëson pikët sipas pikës 3 të nenit 7 të këtij vendimi.

Neni 10
Shpallja e fituesve

1. Për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike, aplikantët, në përfundim të procedurës së konkurrimit dhe intervistës, duhet të kenë fituar jo më pak se 60 pikë.

2. Në përfundim, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike shpall me vendim aplikantët që caktohen për të ofruar ndihmën juridike, së bashku me pikët përkatëse dhe fton zyrtarisht fituesit me jo më pak se 60 pikë të nënshkruajnë kontratën e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike.

Neni 11
Afati

Kontrata e shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike ka vlefshmëri kohore 2 vjet nga data e nënshkrimit të saj. Në përfundim të kësaj periudhe kohore, në varësi të rezultateve, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ricakton për të njëjtën periudhë avokatët, zyrat e avokatisë apo organizata jofitimprurëse, me vendim të veçantë, por pa zbatuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

Neni 12
Avokatët e caktuar kryesisht në çështjet penale

1. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë me qëllim zbatimin e kritereve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim edhe për avokatët e caktuar kryesisht në proceset penale.

2. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike informohet dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre kritereve për avokatët e caktuar kryesisht në proceset penale në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE E KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE **Blegina Kodra**	KRYETARI I DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË **Maksim Haxhia**

VENDIM
Nr.3, datë 25.6.2011

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DHE DOKUMENTET QË DUHET T'I BASHKËNGJITEN FORMULARIT TIP TË KËRKESËS

Në mbështetje të nenit 16 pika 1 të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", me propozim të Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI:

Neni 1

Personat që kërkojnë të përfitojnë ndihmë juridike duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e ndihmës juridike.

Kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë që kërkon dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të plotësojë formularin tip të kërkesës, i cili përmban këto të dhëna:

Emri	
Mbiemri	
Atësia	
Amësia	
Ditëlindja (dita, muaji, viti)	
Vendlindja	
Seksi	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Numri i telefonit	

Neni 2

Në rastin kur kërkuesi është i mitur ose person pa zotësi për të vepruar (i është hequr ose kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), formulari i kërkesës së kërkuesit duhet të plotësohet nga përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë me të gjitha të dhënat për kërkuesin të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi dhe krahas tyre plotësohen edhe këto të dhëna të identitetit për përfaqësuesin e tij, të autorizuar me prokurë, si më poshtë:

Emri	
Mbiemri	
Numri dhe data e aktit që tregon cilësinë e përfaqësuesit të tij, të autorizuar me prokurë	
Organi që ka lëshuar aktin	
Vendbanimi (adresa e saktë)	

Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Shtetësia	
Numri i telefonit	

Neni 3

Tabela e të dhënave për format e ndihmës juridike të kërkuar nga kërkuesi:

Sigurim i informacionit juridik	
Dhënia e këshillave dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë	
Plotësimi i akteve të ndryshme juridike	
Dhënia e këshillave juridike për personat që e kryejnë vetë përfaqësimin në gjykatë	
Përfaqësimin e kërkuesit para organeve administrative	
Përfaqësimin e kërkuesit në gjykimin e çështjeve civile, administrative ose penale në gjykatë	

Neni 4

Formulari i kërkesës, me anë të së cilës kërkuesi kërkon ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për një çështje civile apo administrative, i paraqitet Kryetarit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike nga vetë kërkuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar me prokurë.

Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike e shqyrton kërkesën brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së formularit nga kërkuesi dhe vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës.

Ndaj vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike, mund të bëhet ankim në Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së ankimit pranë tij.

Neni 5

Ndihma ligjore përjashtohet në rastet kur:

a) kërkesa është dukshëm e pabazuar në ligj;

b) kostoja e ndihmës juridike tejkalon vlerën e çështjes.

Neni 6

Formularit tip të kërkesës, për çdo rast, duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Fotokopje e dokumentit identifikues të kërkuesit;

2. Kur kërkuesi është i mitur, përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar me prokurë sipas ligjit, formularit të kërkesës duhet t'i bashkëngjiten:

a) fotokopja e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor, të përfaqësuesit me prokurë apo të kujdestarit;

b) fotokopja e dokumentit që provon cilësinë e këtij personi si përfaqësues ligjor, me prokurë apo kujdestar (si certifikatë e gjendjes familjare të kërkuesit, kopja e vendimit gjyqësor të formës së prerë që e ka caktuar atë kujdestar ose kopja e prokurës së përfaqësimit).

3. Dokumentet që vërtetojnë se kërkuesi përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet e mëposhtme për t'u përfshirë në to:

- Nuk ka pronësi kapitale, me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe tokës bujqësore.
- Është i regjistruar si punëkërkues i papunë.

Kërkuesi që përfiton nga programet e mbrojtjes sociale, duhet të paraqesë dokumentin që vërteton kategorinë përfshirëse.

4. Në rast se ai plotëson kushtet për t'u përfshirë në programet e mbrojtjes sociale që duhet të paraqesë për të përfituar ndihmë juridike janë:

- Vërtetim nga zyra e punës;
- Vërtetim nga zyra e tatim-taksave;
- Vërtetim nga zyra e sigurimeve shoqërore;
- Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Vërtetim nga zyra e regjistrimit të automjeteve;
- Vërtetim nga seksionet pranë bashkisë nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre (urbanistika për personat me leje ndërtimi ose ndërtime pa leje, tregu i lirë, shërbimet, transportit, kulturës dhe energjetikës);
- Vërtetim nga Inspektorati i Punës, nëse rezultojnë të punësuar informalisht.

Neni 7

Në rastin kur kërkuesi paraqet kërkesë për dhënien e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12 të ligjit "Për ndihmën juridike" nr.10 039, datë 28.12.2008, formulari tip plotësohet nga personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ose avokati vetëm për qëllime statistikore.

Në këto raste vlefshmëria e kërkesës nuk varet nga forma.

Neni 8

Personi që plotëson formularin tip të përcaktuar me këtë vendim (vetë kërkuesi ose përfaqësuesi ligjor, ai me prokurë apo kujdestari i tij) me të dhënat përkatëse të këtij formulari, ose personi që i deklaron këto të dhëna para personit zyrtar të autorizuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, e nënshkruan këtë formular tip dhe përgjigjet ligjërisht për vërtetësinë e informacionit të pasqyruar në formular dhe saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve që i bashkëngjiten atij.

Neni 9

Në rast se konstatohet dhënia e informacionit të pavërtetë në formularin për dhënien e ndihmës juridike ose pavërtetësi në informacionin e dhënë në dokumentet që i bashkëngjiten këtij formulari, ky fakt përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ndihmës juridike, si dhe mund të shkaktojë përgjegjësi penale për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Blegina Kodra

VENDIM
Nr.4, datë 25.6.2011

MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË AVOKATËVE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE

Në mbështetje të nenit 10 shkronja "dh" të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", me propozim të Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI:

Neni 1

Ky akt rregullon metodën e vlerësimit dhe të përcaktimit të masës së shpërblimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore në fushën civile dhe administrative.

Neni 2

Masa e shpërblimit për avokatët që japin ndihmë juridike parësore dhe dytësore në çështjet civile dhe administrative do të përcaktohet me pikë.

Neni 3
Vlera e pikëve

Vlera e një pike është 1000 lekë.

Neni 4
Dokumentet e nevojshme

Me përfundimin e procedurave të dhënies së ndihmës, avokatët duhet të paraqesin formularin për shpërblimin për ndihmën e ofruar pranë organit kompetent. Bashkë me formularin avokatët duhet të paraqesin:

- fatura origjinale për të gjitha shpenzimet;
- kopje të vendimeve gjyqësore ose administrative;
- kopje të akteve juridike të kryera ku përfshihen:
- të gjitha procedurat e ndërmarra;
- aktet e përpiluara;
- pjesëmarrja në seancat gjyqësore;
- arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore nëse ka;
- ankimet (brenda afateve);
- koha e shpenzuar për përgatitjen e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes;
- mosmarrëveshjet ndërmjet avokatit dhe klientit gjatë procesit lidhur me përfaqësimin;
- mosmarrëveshjet ndërmjet avokatit dhe gjykatës;
- përmbledhje të mbrojtjes dhe rezultatet përfundimtare të çështjes;
- vërtetim nëse përfituesi është i përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike;
- formulari i aplikimit.

Neni 5

Tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Çështje administrative

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim dokumentesh që mundësojnë hapjen e një procesi administrativ dhe dokumente të tjera të nevojshme (strehime, asistencë sociale, aplikime në zyrat e gjendjes civile, sigurime shoqërore, paaftësi për punë)	2 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	3 pikë

Çështje civile pa palë kundërshtare

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim dokumentesh që mundësojnë hapjen e një procesi civil pa palë kundërshtare dhe dokumente të tjera të nevojshme	2 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	3 pikë

Çështje civile me palë kundërshtare

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi civil me palë kundërshtare dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Konflikte pronësie

Veprimet juridike	**Vlerësimi**
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi me objekt konflikt pronësie dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Marrëdhënie detyrimi

Veprimet juridike	**Vlerësimi**
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi që ka për objekt marrëdhënie detyrimi dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Dëm jashtëkontraktor

Veprimet juridike	**Vlerësimi**
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Marrëdhënie pune

Veprimet juridike	**Vlerësimi**
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për ndërprerjen pa të drejtë të marrëdhënieve të punës dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Të gjitha çështjet e tjera që nuk janë të klasifikuara si çështje të veçanta, do të trajtohen si konflikte civile të përgjithshme me ose pa palë.

Çështje familjare

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi me objekt konflikti në fushën familjare dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Zgjidhje martese

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për zgjidhje martese dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Kujdestari

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për kujdestari dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Njohje atësie/amësie

Veprimet juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për njohje atësie/amësie dhe dokumente të tjera të nevojshme	3 pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumenteve gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 pikë

Të gjitha çështjet e tjera që nuk janë të klasifikuara si çështje të veçanta, do të trajtohen si konflikte familjare të përgjithshme.

Përfaqësimi në gjykatën e rrethit gjyqësor

Veprimet juridike	Vlerësimi
Përfaqësimi në gjykim për çështje civile pa palë kundërshtare	15 pikë
Përfaqësimi në gjykim për çështje civile me palë kundërshtare	40 pikë

- Totali i pikëve për një çështje civile pa palë kundërshtare në gjykatën e rrethit gjyqësor nuk mund t'i kalojë 21 pikë.

- Totali i pikëve për një çështje civile me palë kundërshtare në gjykatën e rrethit gjyqësor nuk mund t'i kalojë 49 pikë.

Ankimet

Veprimet juridike	Vlerësimi
2. Përpilimi i ankimeve ndaj një vendimi të gjykatës së rrethit gjyqësor	15 pikë

Përfaqësimi në gjykatën e apelit

Veprimet juridike	Vlerësimi
Përfaqësimi në gjykim në Gjykatën e Apelit për çështje civile me ose pa palë kundërshtare	45 pikë

Rekurset

Veprimet juridike	Vlerësimi
Përpilimi i kërkesës për rekurs ndaj një vendimi të gjykatës së apelit	25 pikë

Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë

Veprimet juridike	Vlerësimi
Përfaqësimi në gjykim në Gjykatën e Lartë për çështje civile me ose pa palë kundërshtare	60 pikë

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

Veprimet juridike	Vlerësimi
Hartimi i dokumenteve (kërkesave) që mundësojnë hapjen e një procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë	25 pikë

KRYETARE
Blegina Kodra

VENDIM
Nr.5, datë 25.6.2011

PËR KRITERET E VLERËSIMIT, FORMAT DHE STANDARDET E KONTROLLIT TË CILËSISË NË OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE

Në mbështetje të neneve 10 shkronja "g" dhe 21 pika 2 të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", me propozimin e Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve, standardeve dhe formave për kontrollin e cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, me qëllim garantimin e standardeve më të larta të profesionalizmit për aksesin real dhe efektiv në drejtësi, sipas ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike".

Neni 2
Kriteret e vlerësimit të cilësisë së ndihmës juridike

Cilësia dhe efektiviteti i ndihmës juridike do të vlerësohet në bazë të përmbushjes së standardeve orientuese në aspektin kohor, cilësor dhe sasior të ofrimit të ndihmës juridike, si më poshtë:

- Koha në të cilën ofrohet ndihma juridike;
- Realizimi i mbrojtjes dhe cilësisë së saj brenda afateve të arsyeshme;
- Zgjidhja me pajtim e mosmarrëveshjeve;
- Vlerësimi dhe pranimi nga gjykata i ankimeve dhe kërkesave të përfaqësimit dhe mbrojtjes;
- Mungesa e ankimeve nga pala kundërshtare;
- Realizimi i çështjeve komplekse me cilësinë e duhur brenda afateve të arsyeshme kohore;
- Komunikimi i mirë me klientin dhe krijimi i marrëdhënies së besimit;
- Komunikimi i mirë dhe profesional me gjykatën apo palë të treta në proces;
- Respektimi i detyrimeve ligjore të profesionit të avokatit sipas ligjit "Për profesionin e avokatisë", statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodin Etik të Avokatit;
- Frekuentimi i aktiviteteve të trajnimit të vazhdueshëm ligjor të avokatëve dhe trajnimeve specifike mbi grupet vulnerabël;
- Komunikimi, bashkëpunimi dhe raportimi te Komisioni i Ndihmës Juridike brenda afateve kohore të përcaktuara.

Lista e kritereve të vlerësimit të cilësisë është e rivlerësueshme në varësi të kategorisë së ndihmës juridike apo të çështjeve përkatëse.

Neni 3
Format e kontrollit të cilësisë së shërbimit

Avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore duhet të kryejnë mbrojtje dhe përfaqësim cilësor në mbrojtje të interesave të përfituesit dhe të jenë të pajisur me njohuritë ligjore dhe kompetencën e nevojshme profesionale.

Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike të ofruar nga avokatët.

Neni 4
Kontrolli nëpërmjet vetëdeklarimit

Avokati raporton në formën e vetëdeklarimit, brenda 15 ditëve pas përfundimit të çështjes, mbi përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar midis avokatit dhe Komisionit të Ndihmës Juridike.

Bashkëngjitur raportit të vetëdeklarimit, avokati duhet të bashkëngjisë kopjet e plota të dokumenteve të çështjes përkatëse. Përpara këtij raportimi, avokati duhet t'i paraqesë Komisionit raport të ndërmjetëm lidhur me ecurinë e çështjes, në përgjithësi, dhe në rast mosmarrëveshjesh me klientin apo të tjera problematika, në veçanti.

Personat e autorizuar nga Komisioni, pasi shqyrtojnë raportin e vetëdeklarimit dhe dokumentacionit përkatës, kur e shikojnë të nevojshme - në rast të mospërputhjes midis raportit dhe dokumentacionit apo kur ka dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e raportimit - thërrasin avokatin dhe klientin e tij për të marrë informacione të mëtejshme për plotësimin e dosjes.

Neni 5
Kontrolli kryesisht

Komisioni i Ndihmës Juridike, nëpërmjet personave të autorizuar, kryen kontrollin kryesisht të cilësisë dhe efektivitetit të ndihmës juridike të ofruar, në çështjet apo kategorinë e çështjeve, të përcaktuara në planin vjetor të kontrollit, të miratuar nga Komisioni në çdo fillim të vitit kalendarik bazuar në çështjet prioritare të ofrimit të ndihmës juridike.

Kryetari dhe Komisioni i Ndihmës Juridike, në varësi të indicieve apo sensibilitetit të lartë, vendos kryerjen e kontrolleve të paplanifikuara nga plani vjetor i kontrollit. Këto kontrolle do të kryhen nga personat e autorizuar nga Komisioni nëpërmjet pjesëmarrjes në seancat gjyqësore dhe bashkëpunimit me avokatin gjatë procesit të ofrimit të ndihmës juridike. Metodat e kryerjes së kontrolleve të paplanifikuara do të përcaktohen rast pas rasti nga Komisioni.

Neni 6
Ankimet

Komisioni i Ndihmës Juridike ndjek dhe verifikon ankesat kundër avokatëve, të paraqitura nga personi i interesuar apo Ministri i Drejtësisë gjatë dhe pas procesit.

Personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike për trajtimin e ankesave regjistron pretendimet e ankuesit sipas formularit përkatës dhe kur e shikon të arsyeshme dhe të bazuar, i propozon Komisionit nisjen e procedurave të kontrollit.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak, personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, përgatit relacionin e kontrollit të ankesës dhe rekomandimin përkatës, të cilin ia kalon Komisionit për verifikim dhe kontroll të mëtejshëm.

Relacioni i kontrollit i kryer nga personat e autorizuar të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike i njoftohet avokatit ndaj të cilit është bërë ankesa së bashku me rekomandimet përkatëse.

Avokati duhet të parashtrojë me shkrim pranë personelit të Komisionit argumentet dhe provat brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 7
Masat lidhur me shkeljen e kritereve ligjore dhe cilësinë e ndihmës juridike

Personat e autorizuar nga Komisioni, në varësi të rezultateve të kontrollit mbi bazë ankese apo të nisur kryesisht, përgatisin relacionin përkatës, i cili i dërgohet për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit. Së bashku me relacionin përkatës mbi shkeljen e detyrimeve ligjore apo konstatimit të cilësisë së dobët të shërbimit, personat e autorizuar i propozojnë Komisionit këto masa:

- ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së avokatit me Komisionin;

- dërgimin e ankesës pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj avokatit;

- përjashtimin nga lista e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore.

Avokati duhet të parashtrojë me shkrim pranë personelit të Komisionit argumentet dhe provat brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Komisioni gjatë shqyrtimit të raporteve të kontrollit, kur e shikon të nevojshme, thërret avokatin për shpjegime të mëtejshme. Komisioni del me vendim lidhur me shkeljen e detyrimeve ligjore nga ana e avokatit dhe përcaktimin e masës përkatëse, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës pranë personit të autorizuar nga Komisioni.

Komisioni i dërgon rezultatet e kontrollit pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë të Shqipërisë, e cila i trajton ato sipas parashikimeve mbi "Procedurën e ankimit dhe disiplinimit të avokatëve" të ligjit "Për profesionin e Avokatit" në Republikën e Shqipërisë, Kodit Etik dhe Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 8
Trajnimi i avokatëve të ndihmës juridike

Komisioni i Ndihmës Juridike në procesin e përzgjedhjes dhe përtëritjes së marrëveshjeve me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike do të marrë në konsideratë, frekuentimin e pjesëmarrjes nga ana e avokatëve, në aktivitetet e trajnimit ligjor vazhdues apo trajnimet specifike mbi të drejtat e grupeve vulnerabël.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Blegina Kodra

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.1.2012
Doli nga shtypi më 8.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 80 lekë